



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 11760 / Prot.

Divjakë më 14 . 11 . 2025

PROJEKT-VENDIMI

Nr. 80 , datë 14 . 11 . 2025

PËR “MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE BASHKISË DIVJAKË” SI DHE MIRATIMIN E METODOLOGJISË LOD PËR FINANCIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE”

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ”, neni 54 germa k, në ligjin nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” në ligjin 9936 dt 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Divjakë i datës 02.10.2025, i propozojmë, Këshillit të Bashkisë Divjakë që, më datë 25 / 11 /2025 ,

Të miratojë:

1. Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Divjakë, sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Metodologjinë për financimin e organizatave të shoqërisë civile, sipas Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor.(LOD).
3. Vlera e plotë e projektit është 100,000 Dollar ose 8,365,000 lekë, nga e cila
 - a. Vlera prej 75,000 Dollar ose 6,273,750 lekë do të financohet nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara për një periudhë 2-vjecare.
 - b. Vlera prej 25,000 Dollar ose 2,091,250 lekë do të financohet nga Bashkia Divjakë, nga ku: -
-Pjesa takuese e Bashkisë Divjakë për vitin 2026 është në vlerë prej 1,045,625 lekë dhe do të planifikohet në Buxhetin e vitit 2026,
-Pjesa takuese e Bashkisë Divjakë për vitin 2027 është në vlerë prej 1,045,625 lekë dhe do të planifikohet në Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

**Përgjegjës për Sektorin Juridik Prokurimeve
Publike dhe menaxhimit të Aseteve**

Andi Bullari

Për Njësinë e Integrimit European dhe Ndihmës së Huaj
Esmeralda Harizi

Për Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola

KRYETARI
Josif Gorrea

